



Бр./Nr. 23 - 3134/1
Скопје/Shkup 02.12.2021 год./vit.

THIRRJE PËR MBLEDHJE TË PROPOZIMEVE PËR PUBLIKIM NË VITIN 2022

Arkivi shtetëror publikon thirrje për mbledhjen e propozimeve për publikime në vitin 2022

Udhëzime për paraqitjen e propozime

1. Komisioni i botimeve do të marrë parasysh llojet e mëposhtme të botimeve:

- komente për tema, ngjarje dhe personalitete të caktuara historike, të krijuara mbi bazën e lëndës arkivore me origjinë nga vendi ose nga jashtë;
- koleksione të materialit arkivore me origjinë nga vendi ose nga jashtë;
- monografi për një ngjarje, problem, çështje, temë ose person të caktuar nga historia e Maqedonisë të krijuara në bazë të materialit arkivore me origjinë nga vendi ose nga jashtë;
- punime profesionale nga fusha e arkivistikës dhe
- botime të tjera për të përmisuar mbrojtjen dhe përdorimin e materialit arkivorë.

2. Përmbajtja e propozimit

Autori (redaktori) e paraqet propozimin për botim Komisionit të botimeve pranë Arkivit shtetëror.

Propozimi detyrimisht duhet të përmbajë:

- titulli i botimit (punues ose përfundimtar);
- emri dhe mbiemri i autorit ose redaktorit të botimit (dhe një biografi e shkurtër me listën e botimeve të botuara për personat që paraqesin propozimin për herë të parë)
- emri dhe mbiemri i autorit në parathënies (hyrjes);
- emri dhe mbiemri i personit që bën përzgjedhjen e dokumenteve (nëse bëhet përzgjedhja);
- pasqyrë e shkurtër e përmbajtjes së publikimit;
- vitet kufitare të materialit që do të publikohet;
- vëllimi i përafërt i materialit (në faqet e autorit, në mënyrë që 1 faqe autorit të korrespondojë 30,000 karaktere me hapësirë midis fjalëve;
- afati kohor për përgaditjen e publikimit (deri 31 mars vitin 2022). Pas përfundimit të afatit publikimet nuk do të pranohen. Nga ky rregull përjashtohen vetëm projektet e Arkivit shtetëror me bashkëpunor të jashtëm dhe arkivave tjera.
- Informacion për kontakt me autorin / redaktorin.

3. Afati për dorëzimin e propozimeve

Afati për dorëzimin e propozimeve për publikim është data 17 dhjetor 2021.

II Udhëzime për përgaditjen e publikimeve

1. Gjatë përgatitjes punimet duhet të bëhen në formë elektronike, me mbështetje maqedonase në një nga programet MS Word, të ruajtura në formatin e dokumentit (**. doc). Përdorimi i fontit Times New Roman është i detyrueshëm. Në tekst, madhësia e shkronjave është 12 pika, dhe hapësira është 1.5. Në fusnota, madhësia e shkronjave është 10 pika, dhe hapësira është më e vogla (single). Nëse punimi nuk rregullohet sipas udhëzimeve nuk do të pranohet, lejohet vetëm teksti i mesëm i plotë në word për procedurë të mëtejshme në arkiv.



2. Nëse në përgatitjen e publikimit përdoret material në gjuhë të huaj, autori/redaktori është i obliguar ta dorëzojë botimin e përkthyer në gjuhën maqedonase, ndërsa shpenzimet e përkthimit i bartë autori/redaktori;

3. Nëse gjatë përgatitjes së publikimit përdoret materiali arkivore që nuk është depozituar në Arkivin shtetëror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, autori/redaktori është i obliguar që një kopje në formë elektronike ose të shtypur ta dorëzojë në Arkivin shtetëror.

Të gjithë të interesuarit mund të dërgojnë propozimet e tyre në adresën e mëposhtme:

Arkivi shtetëror i Republikës së Maqedonisë së Veriut

- për Komisionin e botimeve

Keji "Dimitar Vllahov" nr. 19

1000 Shkup

ose në formë elektronike në e-mailin në vijim: info@arhiv.gov.mk.

Komisioni për botime i Arkivit shtetëror vendos nëse një propozim është pranuar apo jo dhe do të njoftojë parashtruesit e propozimeve deri në fund të janarit 2022.

Arkivi shtetërori cakton recensues për dorëshkrimet e pranuar. Pas dorëzimit të dorëshkrimit dhe marrjes së një vlerësimi pozitiv për të, Arkivi shtetëror lidh një marrëveshje me autorët dhe vendos nëse botimi do të botohet vetëm në formë të shtypur, vetëm në formë elektronike, apo në formë të shtypur dhe elektronike.



Drejtori,
dr Emil Krsteski